**AKT THEMELIMI**
**I SHOQERISE**
**"ROMANO INVEST"Sh.p.k.**

**Z.Lugi Romano,** lindur me 13.11.1962 ne Matino,Itali, me dokument identifikimi nr YB2202317 shtetas Italian,i cili shpreh deshiren sipas kerkesave te **ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Per ShoqeriteTregtare" dhe Ligjit nr. 9723, date 03.05.2007, "Per Qendren Kombetare te Biznesit" QKB**, per krijimin e shoqerise me te dhenat e meposhteme :

**NENI 1**

Themeluesi me anen e ketij akti themelimi krijon nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar te emertuar **"Romano Invest"Sh.p.k. Dt. 30.01.2020**
shoqeri e cila do te veproje ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe ne perputhje me dispozitat e statutit qe i bashkalidhet ketij akt themelimi.

**NENI 2**

Selia e Shoqerise do te jete ne Fier: Lagjja Kastriot, Rruga Andon Profka, zona kadastrale nr 8534,me nr pasurie 5/113-N5.
Shoqeria do te ushtroje veprimtarine per nje periudhe **kohe te pakufizuar, mbi 10 vjet,** me te drejte perseritje per periudhen e metejshme, neqoftese ortaku i vetem bie dakort, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

**NENI 3**

Objekti I veprimtarise se shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "Romano Invest" sh.p.k eshte ne fushen e :

Perpunim akiv. Import-eksport i perpunimit aktiv per artikuj te ndryshem industriale ne fushen e fasonerise, importimi i makinerive industriale dhe tregtimi i tyre.Import eksport, prodhim, tregti me shumice dhe pakice te te gjitha llojeve te konfeksioneve, sherbime te ndryshme, prodhim te konfeksioneve dhe veshjeve, tekstile te pambukta dhe te leshta te te gjitha llojeve, duke punuar per vete dhe per porosi te te treteve brenda dhe jashte Shqiperise. Larje,qendisje,ngjyrosje dhe te gjitha sherbimet e tjera te tekstileve dhe te konfeksioneve. Prodhim te veshjeve te gatshme artizanale te te gjitha llojeve, import, eksport i tyre. Import, eksport dhe tregtim me shumice e pakice i artikujve industrial, elektroshtepiake, elektrike, ushqimore, higjenosanitare, tekstile te tjera si dhe lende te pare dhe ndihmese, makineri dhe pajisje te tjera prodhimi per tekstile dhe veshje, etj. Transport mallrash dhe pasagjeresh brenda dhe jashte vendit. Tregti te automjeteve te ndryshme, autovetura apo automjete, transport pasagjeresh brenda dhe jashte vendit. .Hapje supermarket, bar-resorant,piceri. Organizimin e kurseve per aftesimin profesional ne prodhim konfeksionesh ne pergjithesi. Veprimtari komisionere, konsulencë në fusha të ndryshme,ndërmjetësime.Asistence ne perdorim,riparim,mirembajtje te makinerive industriale.

Shoqeria gjithashtu mund te bashkpunoje me shoqeri te tjera me objekt te njejte ose te ndryshem te saj.

**NENI 4**

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 Leke ( njeqindmije ). Ky kapital eshte i ndare ne 1 pjese Vlera nominale e kapitalit eshte 100 000 Leke ( njeqind mije) .
Ortaku i vetem zoteron 100% te gjithe kapitalit te shoqerise.

**NENI 5**

Kapitali i shoqerise mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimeve qe do te marre ortaku. Ne rast se kapitali i shoqerise per shkak te humbjeve te vertetuara ne dokumentat financiare rezulton me i vogel se gjysma e kapitalit themeltar, ortaku vendos brenda tre muajve nga miratimi i llogarive te percaktoje kete humbje mbi mundesine e prishjes se

vlere jo me te vogel se ajo e humbjeve qe kane mbetur, pa mbuluar fondet rezerve.

**NENI 6**

Ortaku i vetem mund t'u shese te treteve kuota te kapitalit te tij, teresisht apo pjeserisht te shoqerise, te cilet kane te drejten e parablerjes qofte edhe ne kushte te barabarta. Kjo e drejte duhet ushtruar brenda 30 diteve nga data e komunikimit.

**NENI 7**

Organet drejtuese te shoqerise jane :

- Ortaku i Vetem
- Administratori

Afati i emerimit te administratorit eshte 5 vjet, me te drejte riperseritje , ne baze te nenit 95 te Ligjit 9901, dt.14.04.2009, sic eshte percaktuar ne statut.

Procedura per emerimin ne funksionet perkatese dhe shkarkimin e tij rregullohen sipas statutit te shoqerise.

**NENI 8**

Ne mbledhjen e pare te shoqerise emerohet administrator i shoqerise **Z.Luigi Romano** lindur me 13.11.1962 ne Matino,Itali

**NENI 9**

Vendimet e ortakut te vetem mund te merren edhe nepermjet konsultimit me shkrim.

**NENI 10.**

Likujditet dhe transaksionet financiare do te depozitohen ne bankat shqiptare dhe ne ato te huaja, ku shoqeria ka llogaritet e saj rrjedhese. Per kapitalin themeltar te shoqerise eshte hapur libri i llogarive ku do te shenohet kontributi i ortakut te vetem. Po keshtu shoqeria ka dhe perdor dokumentacionin sipas kerkesave te ligjit per kontabilitetin e gjithe kerkesave te tjera financiare te domosdoshme per veprimtarine normale te saj.

**NENI 11**

Fitimi neto i realizuar nga shoqeria i mbetet ortakut te vetem ne perpjestim me kontributin ne kapitalin themeltar te shoqerise, mbasi te jene likujduar te gjitha detyrimet, dhe te jene hequr 5 % qe do te futet ne fondin e rezerves ligjore deri ne permbushjen e l/10 te kapitalit te shoqerise.

**NENI 12**

Shoqeria fillon veprimtarine e saj vetem pasi te kete marre autorizimin e organeve kompetente sipas legjislacionit ne fuqi.

**NENI 13**

Ortaku i vetem eshte i detyruar te ruaje karakterin sekret te dokumentacionit, te eksperiences se shkembyer, te realizuar brenda veprimtarise se shoqerise .

**NENI 14**

Te gjitha mosmarreveshjet qe nuk mund te zgjidhen me mirekuptin, do te paraqiten per zgjidhje ne gjykaten kompetente shqipetare, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi .

**NENI 15**

Ky akt themelimi u perpilua ne prani te ortakut te vetem duke shprehur ne te vullnetin e lire te tij. Akti i themelimit u perpilua ne tre kopje me fuqi te barabarta secila, per t' u depozituar ne organet kompetente, si dhe nje kopje te ruhet ne dokumentacionin baze te shoqerise.

**ORTAKU I VETEM I SHOQERISE**
**"Romano Invest "Sh.p.k.**

**Luigi Romano**